



# NGJALLJA

Nr. 6 (197) Viti XVII i botimit

QERSHOR 2009

Çmimi 20 lekë

**FIER**

## U krye shenjtërimi i kishës së Shën Gjergjit



**T**ë dielën, 14 maj, besimtarët e Fierit u mbledhën në kishën kushtuar Dëshmorit të Madh, Shën Gjergjit, për një shërbesë tepër të veçantë: Shenjtërimin e saj nga Kryepiskopi Anastas.

Në fund të Shërbesës së Mëngjesores filloi Shërbesa e Shenjtërimin, me uratat e lexuara nga Kryepiskopi Anastas, që ndihmohej nga Mitropolit i Beratit, Hirësia e Tij Ignati, Episkop Nikolla, Episkop Andoni dhe klerikë të tjerë.

Më pas u krye 3 herë litania rreth kishës dhe u bë hapja e deryve dhe filloi shërbesa me vendosjen e lipsaneve në Tryezën e Shenjtë.

Gjatë Shërbesës së Shenjtërimin Kryepiskopi shkroi në katër cepat e kishës monogramin e Krishtit (me gerrat XP, Jisu Krishti). Kjo bëhet me Miro të Shenjtë, dyllë dhe aroma të caktuara, që tregojnë veçoritë e Shpirtit të Shenjtë.

Pas shërbesës u krye Liturgjia Hyjnore. Një predikim të veçantë shpirtëror bëri Atë Thomas Hopko, theolog i shquar nga SHBA.

Në fund të saj, për të falënderuar Kryepiskopin Anastas, i cili bëri të

(vijon në faqen 2)

**SHBA**

## Godinë e re për qendrën Hierapostolike

### - Ajo i kushtohet Kryepiskopit Anastas të Shqipërisë dhe Kryepiskopit Dhimitër të Amerikës -

Në Saint Augustine, Florida, në datat 20-21 maj, u përurua Qendra e Trajnimit dhe Administrative e Misionit të Krishterë Orthodhoks (OCMC), e cila u pagëzua me emrin e Kryepiskopit Anastas dhe Kryepiskopit Dhimitër. Në këtë eveniment morën pjesë përfaqësues nga të gjitha juridiksionet e Kishës Orthodhokse në Amerikë, përfshi edhe dioqezat shqiptare, si dhe mbi 300 të ftuar me këtë rast. Qendra e re e Trajnimit është një investim rreth 4 milion dollarë dhe ky investim është përfunduar në sajë të kontributeve të besimtarëve, shoqatave filantropike dhe të kishave të ndryshme në Amerikë.



pjesë të ndryshme të globit.

U nxor në pah ngritja e kishave orthodhokse në Uganda, Tanzani dhe në Kenia nga Kryepiskopi Anastas gjatë veprës së tij apostolike në Afrikë, frytet e kësaj pune të cilat vazhdojnë të kenë lulëzim edhe sot, si dhe vepra e jashtëzakonshme e ringjalljes së Kishës në Shqipëri. Më pas u trajtua puna e madhe baritore dhe administrative e Kryepiskopit Dhimitër në një front kaq të vështirë dhe kompleks siç paraqitet kontinenti amerikan sot, për konsolidimin e besimit orthodhoks dhe Kishës Orthodhokse.

Ceremonia nisi me një pritje në Renaissance Resort në World Golf Village, ku Presidenti i Bordit të OCMC, C. Argue, u uroi pjesëmarrësve mirëseardhjen dhe bëri një përshkrim në kohë të aktivitetit dhe punës së kësaj qendre misionare. Kjo qendër është e pranishme me anë të vullnetarëve të saj, në shumë vende të botës si në Shqi-

përi, Tanzani, Uganda, Rumani, për të ndihmuar përpjekjet e kishave orthodhokse lokale. Drejtor i kësaj qendre është atë Martin Rici, një klerik që ka jetuar dhe ka punuar disa vite edhe në Shqipëri, pranë Kryepiskopit Anastas.

Në darkën që pasoi, folës të ndryshëm, përfaqësues të të gjitha komuniteteve orthodhokse në

Amerikë nxorën në pah rolin primar dhe iniciues që ka luajtur Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Anastasi, si dhe Kryepiskopi Dhimitër, primat i Kishës Orthodhokse Greke në Amerikë dhe Kryetar i Këshillit të Përhershëm të Konferencës së Peshkopëve Orthodhoksë të Amerikës (SCOBA), në veprën apostolike në

Atë Chad Hatfield, dekani i Seminarit të Shën Vladimitrit, përmendi në fjalimin e tij rëndësinë e jashtëzakonshme të misionit orthodhoks në Amerikë, i cili ishte vendimtar në ngritjen e komuniteteve orthodhokse në Amerikën e Veriut nga shenjtorë si shën Hermani i Alaskës, shën Inocenti i (vijon në faqen 6)

## U krye shenjtërimi i kishës së Shën Gjergjit

(vijon nga faqja 1)

mundur ringritjen e kishës së Shën Gjergjit, e mori fjalën Mitropolit i Beratit, Hirësi Ignati, i cili tha ndër të tjera:

“I dashur Fortlumturi, me gjithë zemër ju urojmë në emër të besimtarëve dhe të klerikëve tanë shëndet të plotë dhe jetë të gjatë për të përmbushur me sukses detyrën që ju ka besuar

Zoti Krisht për shpëtimin e shpirtave dhe mbarëvajtjen e Kishës sonë Orthodhokse”.

Më pas, duke falënderuar për fjalët e ngrohja, besimtarëve iu drejtua Kryepiskopi Anastas, i cili tha:

“Dita e sotme është një bekim shumë i madh për të gjithë ne. Mendja ime shkon tek hera e parë që erdha në Fier. Ishte viti 1991 dhe nuk kishte mbetur qoftë edhe një gur nga kisha e vjetër dhe duhet që takimin ta bënim në shesh. Që nga ajo kohë Zoti na bëri të denjë të shikojmë shumë mrekulli dhe shumë dhurata të dashurisë së tij. Dhe sot lavdërojmë Perëndinë për këtë kishë kaq të mrekullueshme në shërbimin tonë.

Dua të falënderoj ngrohtësisht të gjithë ata që ndihmuan që kjo të bëhej realitet. Janë shumë njerëz që kanë emër dhe shumë njerëz anonimë. Ata iu përgjigjën thirrjes sonë dhe mundëm kështu të grumbullojmë fondet e nevojshme që të ngrihej kjo kishë”.



### Si u ringrit kisha

Që në fillim të aktivitetit të tij Kryepiskopi Anastas tregoi një vëmendje të veçantë edhe për rindërtimin e kësaj kishë. Në vitin 1992, për të plotësuar kërkesat imediate, u ndërtua një kishë e vogël, e përkohshme, me parafabrikate, në cepin e truallit ku ngrihej më parë kisha e vjetër e qytetit.

Më pas, me kujdesin, nismën dhe fondet e mblodhura nga Kryepiskopi Anastas, u bë e mundur ringritja e saj.

Më 12 janar 1997, mbi truallin e kishës së vjetër, Fortlumturi e Tij, Anastasi kreu Shërbesën e vendosjes së gurit të themelit të Kishës së re. Kisha është e tipit bazilikë dhe ka një sipërfaqe ndërtimi rreth 1000 m<sup>2</sup>, me lartësi në kupolë rreth 23 metra dhe u projektua për të qenë sa më e ngjashme me kishën e vjetër.

Më 22 prill 2007, u krye Liturgjia e parë Hyjnore nga Kryepiskopi Anastas, i cili bashkëmehoi me Mitropolitin e Beratit, Hirësinë e Tij Ignatin dhe me Episkopin e Apollonisë, Hirësinë e Tij Nikollën. Qindra besimtarë u mblodhën në kishën e re të Shën Gjergjit, në qendër të Fierit. 40 vjet pasi ishte shembur dhunshëm kisha e vjetër.

Kisha e Shën Gjergjit dy vitet

që ka hapur dyert, megjithëse pa u kryer ende Shërbesa e Shenjtërimin të kishës, me qëllim që t'i shërben-te sa më mirë besimtarëve të saj. Por që një tempull të plotësohet përfundimisht, duhet që të kryhet Misteri i Shenjtërimin të Kishës dhe vendosjes së lipsaneve të shenjtoreve mbi Tryezën e Shenjtë. Kur është e mundur, këto lipsane duhet të jenë të martirëve që dhanë jetën për Kishën, për të plotësuar origjinën e vërtetë të kësaj shërbese shenjtërimi, që vjen nga shekujt e parë të krishterimit, atëherë kur Liturgjia Hyjnore dhe shërbesat kryheshin mbi varret e martirëve.



### Historia e kishës

Fieri është qytet relativisht i ri, por i vendosur në qendër të një zone të dalluar për përkushtimin e besimtarëve të shumtë orthodhoksë. Kishat në çdo fshat kanë qenë të zbuluara me vepra të rralla arti kishtar, të mjeshtërve më të mirë. Por vëmendjen kryesore e tërheqin perlat e besimit orthodhoks, të ngritura që në shekujt e parë, kur besimi i krishterë nisi të përhapej fuqishëm në këto treva. Nga njëra anë e Fierit është qyteti antik i Byllysit, qendër tepër e rëndësishme kishtarë, me bazilikat e shumta apo bazilika e famshme e Gllavenicës në Ballsh. Nga ana tjetër, janë manastiret e shumta, ku veçohen Apollonia, Ardenica, Kolkodasi etj.

Edhe kisha e vjetër e Shën Gjergjit ishte dikur një nga monumentet më të bukura dhe më të mëdha të rajonit të Myzeqesë. Ajo përbëhej prej sallës 3-nefshe, pagëzimores, dy portikëve, si dhe kullës së kambanores mbi të cilën ndodheshin piktura murale e Shën Gjergjit dhe ora e madhe e qytetit. Kjo faltore u ndërtua mbi rrënojat e një kishë më të vjetër të quajtur “Shën Maria”, e cila ka ekzistuar shumë kohë më parë. Në vitin 1923, në vend të kambanores së vjetër u ngrit kambanorja e re.

Mbishkrimet e Shën Gjergjit të Fierit kanë qenë të pakta. Gjithsej ajo mbartte dy mbishkrime. I pari gjendej në pjesën e jashtme të absidës dhe tregonte se në vitin 1782 kishën e kishte ndërtuar qysh nga fillimi kryemjeshtri Gega (Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave të Shqipërisë*, Tiranë 1998, fq.108). Mbishkrimi i dytë ishte vendosur në një pllakë të vendosur mbi derën jugore. Aty gjendej i skalitur emri i mjeshtrit të dytë, që kishte punuar për ndërtimin e kishës, i cili quhej ELAMEN.

Kisha ishte ndërtuar me gurë shtufi dhe mermerë të sjellë nga Apollonia. Një pjesë e gurëve të saj ishin skalitur prej mjeshtërve ndërtues. Gurët ishin lidhur me llaç gëlqereje, ku për të shtuar fortësinë e tyre ishin përdorur edhe të verdhat e vezëve, përzier me lesh dhie. Për kupolën janë përdorur tulla të kuqe të lidhura me llaç.

Kisha e Shën Gjergjit ishte zbuluar brenda me afreske nga piktori grabovar Joan Çetiri, në vitin 1782.

Mbasi u shërbeu afërsisht për 185 vite besimtarëve të zonës, kisha u shkatërrua plotësisht nga dora ateiste më 23.04.1967, ditën e Shën Gjergjit. Nga kjo kishë kanë ngelur disa relike nga ikonostasi i saj i famshëm që ndodhet në muzeun historik të Fierit.

## Familja, shoqëria, integrimi

- Aktiviteti u organizua në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Familjes -

Aktiviteti, që u organizua në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Familjes, mbledhi në datën 15 maj, në Tirana International Hotel, gra përfaqësuese të besimeve tradicionale fetare: myslimane, orthodhokse, katolike e bektashiane; si edhe gra nga jeta diplomatike, politike, biznesi e shoqëria civile etj. dhe shumë të ftuar të tjerë.

Konferenca u organizua me nisim të znj. Iris Maçi, drejtore e departamentit të gruas pranë Komunitetit Mysliman, si edhe të znj. Valbona Duri, juriste nga Shoqëria Civile dhe kishte si temë: "Familja, shoqëria, integrimi". Kjo konferencë kishte për qëllim shpalosjen e vlerave të familjes në shoqëri.

Gjatë konferencës, e cila zgjati për më tepër se një orë, morën fjalën dhe përshëndetën shumë nga të ftuarit. Të gjithë folësit, pasi përgëzuan grupin e grave organizatore për angazhimin tyre në sensibilizimin e shoqërisë civile në lidhje me rëndësinë dhe rolin që luan familja në të, u përqendruan rreth temës, duke e trajtuar atë nga këndvështrimi dhe roli i tyre përkatës.

Gratë përfaqësuese të komuniteteve fetare në Shqipëri folën gjithashtu mbi rëndësinë dhe rolin e familjes në shoqëri, e parë kjo nga këndvështrimi fetar. Përfaqësuesja e komunitetit orthodhoks, znj. Sonila Dedja, në fjalën e saj theksoi rëndësinë që Kisha i jep formimit të familjes. Kur dy njerëz lidhen me njëri-tjetrin, ata lidhen përpara Perëndisë me Misterin e Martesës. Në këtë Mister marrin pjesë përveç klerikëve edhe anëtarë të komunitetit, të cilët urojnë dhe lutën njëkohësisht që kjo familje të rritet dhe të vazhdojë të jetojë me dashurinë dhe me respektin për njëri-tjetrin dhe për Perëndinë, i Cili i lidh.

Folësit e tjerë, pasi bënë edhe një retrospektivë historike mbi krijimin e familjes, parë nga këndvështrimi të ndryshme, theksuan se familja është e shenjtë, është bërthama themelore e shoqërisë, është një "kishë". Kësaj tematike iu referuan edhe përshëndetjet nga përfaqësuesit e krejeve të komuniteteve fetare, të pranishëm në këtë konferencë.



Çast nga veprimtaria "Familja, shoqëria, integrimi"

Nga klerikët e pranishëm, për Kishën Orthodhokse foli Episkopi i Krujës, Hirësi Andoni, i cili ndau me të pranishmit disa nga shqetësimet e shprehura në takimin e përbashkët ndërmjet Kishës Katolike dhe asaj Orthodhokse, mbajtur në Trento të Italisë, në dhjetor 2008, me temë "Familja, një e mirë për njerëzimin". Ndër të tjera ai theksoi rolin e familjes si institucioni më i vjetër i themeluar nga Perëndia dhe ambienti më unikal në të cilin dhurata e jetës njerëzore duhet të transmetohet përmes aktit martesor. Të dy Kishat në deklaratën e përbashkët përgëzojnë aktet ndërkombëtare në mbrojtje të të drejtave të njeriut, por në të njëjtën kohë tërheqin vëmendje në tendencat e fundit për të ndryshuar gjuhën dhe për të prezantuar terma e koncepte të dykuptimshme, gjë që mbetet një shqetësim për të ardhmen. Gjithashtu, ai theksoi ndikimin negativ që luan emigracioni në familjet e sotme, kjo edhe në vendin tonë, duke shkaktuar trauma e tragjedi të shumta familjare e duke

privuar mjaft fëmijë nga dashuria e përkujdesi prindëror.

Një vend të rëndësishëm, theksoi ai, deklarata i kushton gruas në rolin e nënës, si rritësjë dhe edukatorja e fëmijëve. Ky rol kurrsesi nuk duhet të konsiderohet më i ulët e më pak i rëndësishëm se shumë profesione të tjera të nderuara dhe për këtë arsye nënat kanë nevojë për mbështetje morale dhe financiare nga shoqëria dhe politika në mënyrë që t'iu mundësojë atyre përmbushjen e këtij misioni kaq të rëndësishëm, siç është ai i rritjes dhe edukimit të fëmijëve. Në këtë kontekst, ka rëndësi të kuptohet se prindërit mbeten edukatorët e parë të fëmijëve të tyre. Ky rol është i pazëvendësueshëm dhe i patjetërsueshëm dhe për pasojë e pamundur për t'iu deleguar tërësisht të tjerëve ose të kryhet nga të tjerë. Në këtë kuptim mbetet edhe edukimi fetar nga prindërit për fëmijët e tyre. Duke folur për edukimin, ai u ndal gjithashtu edhe në edukimin gjinor (seksual) të të rinjve, për të cilin theksohet qartë në deklaratë

se parim kryesor i tij duhet të jetë drejtimi dhe formimi i të rinjve me kuptimin e jetës dhe dashurisë martesore. Në të njëjtën kohë rëndësi merr dhe mbështetja e familjeve të reja, inkurajimi dhe këshillimi i tyre, duke shmangur lënien në harresë dhe braktisjen e tyre në problemet dhe vështirësitë e përditshme.

Në përfundim, Hirësi Andoni theksoi se familja nuk duhet të konsiderohet kurrsesi si një koncept i dalë mode e anakronik, por i kuptuar drejt ai mund të përbëjë rizbulimin më të drejtë për të ardhmen dhe që ka nevojë më së tepërmi shoqëria jonë. Pa dashurinë e ndërsjellë të familjes shoqëria jonë rrezikon të vdesë.

Konferenca u mbyll me falënderime për të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e dhënë me diskutimet, mendimet dhe sugjerimet e vlefshme të ngritura prej tyre, duke shprehur njëkohësisht për një bashkëpunim edhe në të ardhmen për të mirën e shoqërisë sonë.

Korresp. i Gazetës "Ngjallja"

**RADIO "NGJALLJA", NË FM 88.5 MHz.**

Ajo transmeton për ju 24 orë program.

Do të dëgjoni gjithçka që ju duhet: programe shpirtërore, sociale dhe kulturore.

Muzikë e zgjedhur kishtarë, popullore dhe klasike, nga vendi dhe bota.

Ndiqui shërbesat kishtarë në Radio "Ngjallja"!

## Elbasan - Më shumë dritë në panairin e Shën Joan Vladimirit

Pasditja e 3 qershorit solli dritë e gëzim të ri në manastirin e Shën Joan Vladimirit, pranë Elbasanit. Besimtarët erdhën grupe-grupe, me besë e shpresë, për t'u falur tek shenjtja. Dhe nuk ishin të paktë. Erdhën si çdo vit nga qytete e fshatra brenda vendit tonë dhe jashtë tij, veçanërisht nga Mali i Zi. Erdhën edhe të besimeve të tjera, duke ditur e besuar në mrekullitë e këtij shenjtori çudibërës.

Agripnia, filloi me bekim të veçantë, duke pasur në altar dy episkopë, Hirësi Ilian dhe Hirësi Andonin. Në meshim ishin edhe tetë priftërinj dhe dy dhjakonë. Orët e shërbesës rrodhën pa u ndjerë. Përveç kishës edhe oborri rreth e qark, ishte mbushur me të rinj, burra e gra. Ai llamburiste nga dritat e shumta. Shërbesat u ndoqën dhe u kryen në qetësi të plotë.

Në kishë e jashtë saj, kudo, shërbenin studentët e Akademisë Teologjike të Shën Vlashit. Por edhe si psaltë të muzikës bizantine ata jepnin maksimumin. Kështu mbaroi liturgjia hyjnore e mesnatës,

për të pritur vazhdimin e saj në ditën e re. Arka e lipsaneve të shenjtit, mbeti e ndriçuar nga lambadhet e lutjet e papushuara, e kështu vazhdoi edhe më pas. Të gjithë sa vinin në kishë, i luteshin shenjtut në heshtje, me zemër e shpirt, për shëndet të tyre, familjeve, famullive dhe gjithë botës.

Mëngjesi filloi përsëri me rënie e kabanës dhe fillimin e Liturgjisë Hyjnore. Tok edhe me priftërinjtë

e kishës malazeze dhe gjithë besimtarët e mbledhur u krye litanja e shenjtut, me tri rrotullimet jashtë kishës. Me besimtarët e shumtë të mbledhur, u bashkuan edhe ata të ardhur rishtas nga Vlora e Beratit e të tjerë, të cilët nuk patën mundësinë të vinin e ndiqnin shërbesat e mbrëmjes e mesnatës.

Pas liturgjisë hyjnore e litanisë së shenjtut i erdhi koha pritjes së autoriteteve zyrtare, e cila kryhet

vit pas viti në traditë dhe u bë nga dy episkopë, Hirësi Ilia dhe Hirësi Andoni. Erdhën për të uruar besimtarët e shumtë ministri i jashtëm z. Lulzim Basha, prefekti i qarkut të Elbasanit z. Shefqet Deliallisi, deputetja, znj. Valentina Leskaj, kryetari i këshillit të komunës Bradashesh, z. Sabri Sallaku etj.

Në drekë, tok me studentët e Akademisë Teologjike, Shën Vlash, Durrës dhe klerikët tanë, shtrohen edhe klerikët dhe besimtarët e ardhur nga Mali i Zi. Edhe ata janë të gëzuar e lumturuar me bekimin e madh që patën, që iu bashkuan lutjeve e himneve të besimtarëve tanë dhe lavdëruam bashkërisht shenjtin e madh mrekullibërës shën Joan Vladimirin. Ata, shprehen të kënaqur me orët që kaluan në manastir dhe ndjehen të mbushur me më shumë me besë e shpresë dhe tepër të privilegjuar që morën pjesë në këtë kremtim të ndritshëm, të përvitshëm.

*Korresp. i "Ngjallja"*



*Agripni në Manastirin e Shën Joan Vladimirit*

### **Mbresa nga një ditë e shënuar!**

## *Mos e harroni Sinicën!*

**K**a disa vjet që Sinica, fshati i bukur në Devollin e Sipërm, çdo 20 maj gjallërohet si në asnjë ditë tjetër të vitit. Është dita e Shënkollit, e cila prej disa vjetësh mbledh sinicarët nga viset e ndryshme ku punojnë e jetojnë si në Korçë, Tiranë, Elbasan, Durrës, etj. Kjo ditë, si një zile shkolle që mbledh nxënësit e saj, mbledh edhe sinicarët e shpërndarë nëpër botë si Greqi, Amerikë, Kanada, Itali, etj. Shënkolli, si dhe ditët e tjera të shënuara, janë përkujtuar në shekuj nga familjet e këtij fshati. Edhe në vitet e monizmit, kur feja u ndalua, këto familje i përkujtonin ato ditë në "ilegalitet".

Pas viteve nëntëdhjetë, kur edhe feja u kthye në "identitet", kjo ditë mori përmasa të mëdha. Veç familjeve të krishtera, për të takuar bashkëfshatarët e për të festuar tok me 'ta', vijnë edhe familjet myslimane të këtij fshati që banojnë këtu, në rrethet e ndryshme të vendit ose në emigracion. Kështu ndodhi edhe sivjet. Rreth 200 sinicarë, miq e shokë të tyre, u mbledhën së bashku për të festuar këtë ditë të shënuar. Kishin ardhur nga Tirana vëllezërit Dhimitër e Petraq Lumi së bashku me gratë e tyre si dhe Ilir Lumi, të cilët nuk e harrojnë asnjëherë Sinicën. Nga Durrësi kishte ardhur

Skënder Hysolli së bashku me gruan dhe djalin, nga Elbasani, si çdo vit kishin ardhur Niko Dimashi, Dhimitër Gjelo, Rasim e Beqir Memeli së bashku me gratë, etj. Këtë vit kishte edhe mysafirë nga Gramshi, siç ishte Hekuran Cuniku me gruan e tij. Disa sinicarë kishin marrë rrugën nga Amerika e largët për të qenë në këtë ditë të shënuar me bashkëfshatarët e tyre. Një nga ata ishte peshkopi Ilia Ketri, i cili edhe drejtoi meshën e asaj dite, mbajtur në kishën e fshatit. Po nga Amerika, kishin ardhur edhe Sotir Guta e Perikli Sulari, si dhe qytezari Nasi Iskali me gruan e tij.

Veprimtaritë e asaj dite filluan me mbajtjen e meshës në kishën e fshatit. Peshkop Ilia Ketrin e shoqëronin edhe prifti i zonës, Viktor Konomi si dhe studentët e Shkollës Teologjike të Shën Vlashit në rrethin e Durrësit, të cilët kishin ardhur posaçërisht atë ditë. Jo vetëm të krishterët, por edhe myslimanët shkuan në kishë, ndezën qirin dhe u lutën për shëndet e mbarësi në familjet e tyre. Sinica është një nga modelet e bashkëjetesës fetare në Shqipëri. Kështu ka qenë në shekuj e kështu vazhdon edhe sot!

*Marrë nga gazeta "Ndryshe"*



## Këshilli Botëror i Kishave

# MESAZHI I PENTIKOSTISË 2009

*“Vëllezër dhe motra, çfarë duhet të bëjmë?” (Veprat 2:37).*

Viti 2009 filloi me një shqetësim të madh rreth situatës katastrofike të ekonomisë botërore. Në fund të vitit 2008, në mes të një jete që për shumë vetë zhvillohej pa probleme, papritur dolën në dritë vështirësi financiare dhe ekonomike.

Kjo na solli në mendje Pentikostinë e Parë të erës së krishterë, kur çdo gjë dukej se po shkonte mirë për besimtarët e asaj epoke. Shumë prej tyre kishin bërë pelegrinazhin e zakonshëm në Jerusalem për të shënuar kremtimet. Ata erdhën me qëllime të mira për të bërë adhurimin siç bëhej zakonisht. Por kur Shpirti i Shenjtë erdhi si një erë e fortë dhe plot me zhurmë mbi dishepujt, duke i mbushur ata dhe duke i drejtuar “të flasin në gjuhë të tjera siç Shpirti i Shenjtë u jepte të flisnin”, pelegrinët u habitën dhe pyetën veten: “Si është e mundur që secili nga ne, dëgjon në gjuhën tonë, në të cilën kemi lindur?” (Veprat 2:1-13).

Kjo ishte një eksperiencë e jashtëzakonshme dhe tepër e fortë për këta pelegrinë nga e tërë bota. Petro, i transformuar krejtësisht dhe shumë kurajoz, i dha një përgjigje të saktë pyetjeve të tyre në formën e ftesës që u bëri për të ndryshuar zemrat dhe sjelljen e tyre (Veprat 2:14-36).

Duke ndjekur fjalimin energjik të Petros, zemrat e pelegrinëve u prekën thellë dhe ata thanë: “Vëllezër dhe motra, çfarë duhet të bëjmë?”. Kjo përgjigje ishte fillimi i pendimit, i “metanoia”, i atij transformimi të thellë të njeriut, gjë që e drejton drejt një mënyre të re të vepruari. Petro u përgjigj atyre duke u thënë: “Pendohuni dhe le të pagëzohet secili nga ju në emrin e Jisu Krishtit, për ndjesën e mëkateve dhe ju do të merrni dhuratën e Shpirtit të Shenjtë” (Veprat 2:38).

Pendimi vjen vetëm pasi ne pranojmë veprat tona të gabuara dhe sjelljen tonë të shtrembër. Shumë nga ata që kanë përgjegjësi në botën e sotme, duhet të pranojnë se kanë qenë të pandjeshëm në menaxhimin e burimeve të planetit tonë: i pasuri bëhet gjithnjë më i pasur, në dëm të të varfrit që jeton në një varfëri të thellë; i varfëruari nuk ka fuqi, për shkak të gjendjes së tij, për të kundërshtuar atë që i imponohet.

Si në Afrikë apo në Azi, ashtu dhe në çdo kontinent tjetër, situata është kudo e njëjta. Duke u përballur me këtë gjendje, pyetja më e mprehtë është ende kjo: “Vëllezër dhe motra, çfarë duhet të bëjmë?”.

Edhe një herë tjetër, Perëndia na jep përgjigjen më të mirë se çdo lloj përgjigje tjetër: “Pendohuni!”. Pendimi në botën e sotme do të përfshijë:

- Manaxherët e korporatave duhet të pranojnë gabimet e tyre, t’i pohojnë ato publikisht dhe t’i korrigjojnë.

- Të gjithë ne që jemi përgjegjës për degradimin e ekosistemit, duhet të drejtojmë rrugët tona dhe të bëjmë përpjekje për reduktimin e çdo forme ndotjeje.

- Ata që nxisin dhunën, duhet të inkurajohen të bëhen zemërdhembshur dhe tolerantë, të qëndrueshëm në lutjen tonë, që “Dekada ekumenike e Kapërcimit të Dhunës”, e cila është në mbyllje e sipër, të mos përfundojë pa lënë një impakt ndër ne.

Pendimi që u lëçit nga Krishti dhe që u ripohua fuqimisht në Pentikosti, është një forcë për transformim shpirtëror, për ndryshim dhe ripërtëritje. Qeniet njerëzore duhet të kërkojnë të pajtohen me veten e tyre, me njëri-tjetrin dhe me ambientin e tyre; kishat duhet të vazhdojnë të kërkojnë pajtim. Kjo është një sfidë për Ungjillin e Pajtimit dhe ngrihet përsëri këtë vit si çështje në Vitin Ndërkombëtar të Pajtimit të Kombeve të Bashkuara, 2009.

Le të gjejmë që të gjithë fuqinë dhe vullnetin për t’i dhënë një kuptim të ri, thirrjes “Po, ne mundemi!”. Çdo gjë është e mundur për ata që besojnë.

Zoti na bekoftë të gjithëve dhe ne i urojmë secilit një Pentikosti me të vërtetë të gëzuar!

*(Presidentët e Këshillit Botëror të Kishave)*

*Kryepiskopi Dr. Anastasi, i Tiranës dhe i gjithë Shqipërisë, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë.*

*Z. John Taroanui Doom, Kisha Protestante Maohi, Polinezia franceze.*

*Rev. Dr. Simon Dossou, Kisha Metodiste Benin.*

*Rev. Dr. Soritua Nabaan, Kisha Protestante Batak Indonezi.*

*Rev. Dr. Ofelia Ortega, Kisha Presbiteriane e Reformuar, Kubë.*

*Patriarku Abuna Pavlos, Kisha Orthodhokse Etiopiane, Tewahedo.*

*Rev. Dr. Bernice Powell Jackson, Kisha e Bashkuar e Krishtit, SHBA.*

*Dr. Mary Tanner, Kisha e Anglisë.*

## Godinë e re për qendrën Hierapostolike

(vijon nga faqja 1)

Moskës, shën Tihoni dhe vazhdon të jetë i domosdoshëm edhe në ditët tona. Ai tha në diskutimin e tij se sot orthodhoksia ekziston dhe është një shpresë e gjallë për mbarë kontinentin amerikan falë lutjeve, kuptimit dhe përpjekjeve të tyre shumë të mëdha të atyre barinjve dhe besimtarëve të frymëzuar që iu përgjigjën me tërë zemër thirrjes së Krishtit për të mësuar dhe për të bërë nxënës në të gjitha kombet.

Mëngjesi i ditës së enjte, 21 maj, nisi me një Liturgji Hyjnore në kishën e Trinisë së Shenjtë, në Saint Augustine. Pas celebrimit të Liturgjisë, pjesëmarrësit shkuan në ambientet e Qendrës së Trajnimit dhe të Administratës së Misionit Orthodhoks, ku nën kryesimin e Kryepiskopit Anastas, Kryepiskopit Dhimitër dhe Kryepiskopit Jona u krye Shërbesa e Bekimit dhe e dedikimit kësaj qendre.

Kryepiskopi Anastas, gjatë kësaj shërbese i dhuroi për më tepër Qendrës së re Misionare një pjesë nga lipsani i shenjtë i Shën Kozma të Etolisë, duke theksuar rolin e madh të shenjtorit si një prej vazhduesve më të shquar të veprës apostolike dhe vuri në pah jetën e shenjtë dhe sakrificën e madhe të isapostullit të madh, si një model i gjallë dhe frymëzues për çdo njeri që ka thirrjen nga Perëndia për përhapjen e Ungjillit të Krishtit. Kryepiskopi Dhimitër dhuroi një ikonë të shenjtoreve misionarë Kirill dhe Metod, ndërsa Kryepiskopi Jona një pjesë të lipsanit të Shën Inocentit të Alaskës.

Pas kësaj ceremonie, të ftuarit e shumtë u drejtuan përsëri në Renaissance Resort, ku u dha një drekë në nder të Kryepiskopit Anastas dhe Kryepiskopit Dhimitër. Në këtë drekë, atë Aleksandër Veronis bëri një prezantim të personalitetit dhe veprës së Kryepiskopit të Tiranës dhe gjithë Shqipërisë, Anastasit, ku risolli kujtime vetjake të shumë viteve më parë. Në këto refleksione atë Aleksandri kujtoi kontributin dhe rolin e madh dhe të veçantë që Kryepiskopi Anastas luajti në rilindjen dhe në gjallërimin e lëvizjeve hierapostolike, si në ambientet uni-



versitare, ashtu edhe në ato kish-tare, gjatë viteve 50-60. Ai përmendi disa prej ideve të guximshme që Kryepiskopi Anastas parashtrio në atë kohë si linja në të cilat duhet të zhvillohej dhe të jepte fryte e gjithë kjo punë hierapostolike, ide që ngelen të freskëta dhe me një rëndësi të madhe edhe sot për mbarë Kishën Orthodhokse.

Pas këtij prezantimi, Kryepiskopi mbajti një fjalim përsëritës, ku foli dhe parashtrio shumë ide dhe refleksione që burojnë nga një përvojë e gjallë dhe frymëzuese në lëmin e veprës hierapostolike. Ai rikujtoi vitet e kaluara në Afrikë, vështirësitë dhe sfidat e shumta si në ambientin e brendshëm kishtar, ashtu edhe në atë të jashtëm, përgjegjësinë e madhe ndaj Zotit që na urdhëroi të predikojmë në mbarë botën dhe rëndësinë e një thirrjeje të tillë. Ai solli para të pranishmëve, me një përshkrim tërheqës, skena nga jeta dhe vepra e Kishës në kon-

tinëtin afrikan. Në refleksionin e tij, Kryepiskopi Anastas e lidhi veprën hierapostolike me Ngjalljen e Zotit Jisu Krisht, si një ngjarje vendimtare që jep shpresë, dritë dhe fuqi në perspektivën e trishtë të jetës njerëzore. Ai theksoi se Zoti i porositi nxënësit e Tij të shkonin dhe të predikonin në mbarë kombet, pasi ata kishin parë dhe jetuar Ngjalljen e Tij më përpara dhe pasi u veshën me fuqinë dhe shpresën e kësaj ngjarjeje unikalë. Prandaj edhe për një njeri që është i thirrur në këtë vepër hierapostolike, është diçka esenciale në punën dhe në jetën e tij, që përpara gjithë të tjerave, të jetë vetë një shembull dhe provë e gjallë e Ngjalljes së Zotit dhe kjo është mënyra më e mirë që Ungjilli të predikohet saktë dhe në mënyrë efikase. Kryepiskopi Anastas, në fund të refleksioneve të veta, tha se edhe kjo qendër që sapo u përuar, përbën një çast të rëndësishëm në tërë përpjekjen hierapostolike të

Kishës dhe një fillim për të punuar më me përgjegjësi dhe autenticitet në këtë fushë kaq të vështirë.

Ndërsa Kryepiskopi Dhimitër i Amerikës, në fjalën e tij, përmendi domosdoshmërinë e veprës hierapostolike brenda Amerikës, si një mundësi që shumë njerëz që deri më sot nuk e kanë njohur Krishtin të krijojnë një njohje personale me Atë. Ai përmendi numrin e madh të statistikave që flasin për një rritje të numrit të madh të atyre njerëzve që deklarohen ateistë, ose agnostikë në këtë kontinent dhe foli për detyrën që Kisha Orthodhokse në Amerikë ka për të përçuar të vërtetën në këto shtresa të popullsisë. Ai nxori në pah problematika të ndryshme që lidhen me sfidat që krishterimi ballafaqohet në një shoqëri multifetare dhe etnike siç është ajo e Amerikës dhe nevojën e jashtëzakonshme që kanë njerëzit për të njohur Krishtin. Për më tepër vepra hierapostolike ka edhe një përmasë tjetër që është eskatologjike dhe gjithëpërfshirëse, pasi pranimiti i Ungjillit nga njerëzit në botë, do të thotë afrim edhe i Ardhjes së Dytë të Zotit dhe i Mbretërisë së Perëndisë. Prandaj edhe kjo është një detyrë për të gjithë të krishterët, kudo që ndodhen e jo vetëm e klerikëve ose e atyre që janë thirrur për të bërë vepër hierapostolike, tha midis të tjerave Kryepiskopi Dhimitër në fjalimin e tij.

Gjatë këtij evenimenti, kishte një interesim të madh nga media e krishterë, e cila e mbuloi gjerësisht këtë ngjarje, duke transmetuar dhe botuar shkrime e intervista të të ftuarve të nderit dhe të atyre që zbatuan dhe vunë në jetë këtë projekt.



## “Ne duhet të shkojmë të takojmë popullin tonë”

Nga KIRILI,  
Patriark i Moskës dhe i gjithë Rosisë

*Nga fjala e Patriarkut të Moskës KIRIL, gjatë një sesioni të Këshillit të Shtetit dhe Këshillit për bashkëpunim me organizmat fetarë, organizuar më 11 mars 2009 në qytetin e Tulës, 200 km në jug të Moskës.*

[...] Para Revolucionit, Kisha Ruse ishte Kishë e Shtetit, dhe në krye të saj kishte perandorin. Ajo përfitonte privilegje të shumta, por nuk mund të vepronte, veçse kur vendimet e saj përputheshin me vullnetin e pushtetit dhe me linjën politike të shtetit. Populli rus ishte orthodhoks: shumica e njerëzve mbanin lidhje me Kishën, vetëm duke u kunguar një herë në vit. Prandaj dhe një nga preokupimet e mëdha të Kishës ishte të ndërtonte kisha, që ky popull i madh besimtarësh orthodhoksë të mund të merrte pjesë në kremtimet liturgjike.

Mjafton të shëtitësh në disa lagje historike të Moskës ose në qendër të Tulës që të bindesh: praktikisht të gjithë ishin besimtarë, pra duhej organizuar jeta në enori. Pothuajse në çdo cep të rrugës kishte një kishë, ku besnikët të shkonin rregullisht në shërbesat liturgjike, jo në largësi të mëdha. Në këtë mënyrë u formua nocioni “enori”. Në gjuhën ruse vetë fjala “enori” (“prohod”) nënkupton vendin ku njerëzit vijnë.

Në këtë mënyrë u formua edhe një model i priftit: prifti qëndronte në kishë dhe priste që njerëzit të vinin tek ai. Dhe përderisa të gjithë ishin besimtarë, të paktën një herë në javë një numër i konsiderueshëm njerëzish shkonin në kishë. Kjo skemë ka funksionuar në kuadrin e një qytetërimi me tipare të veçanta, një qytetërim funksional, i cili bazohej në lidhjen praktikisht absolute të popullit me vlerat fetare. Dhe gjithçka shkonte mirë! [...]

Por në vazhdim, ndodhi revolucioni, persekutimet, mbyllja e kishave dhe e manastireve, populli u nda nga Kisha. Disa shkonin në kisha thellë ende të hapura për t’u lutur, disa nuk shkonin më hapur, sepse kishin frikë nga shtypjet, ndërsa të tjerë e frekuentonin kishën me gjithë ndalimet. Dhe kishat e rralla ende të hapura ishin plot, dhe kjo të krijonte iluzionin përsëri se gjithçka shkonte mirë, ndërkohë që realisht shoqëria ishte e ndarë nga besimi dhe Kisha.

Me ndryshimet që filluan në periudhën e sotme, një nga punët e para të Kishës ka qenë të restauronte dhe të ndërtonte kisha. Shumë të tilla u ndërton këto njëzet vitet e fundit. Por



ka diçka që nuk ka ndryshuar me të vërtetë: zakoni ta konsiderosh kishën si një vend ku njerëzit “shkojnë”, një vend në të cilin ata e gjejnë vetë udhën e tyre. Ky është një zakon i ankoruar mirë në mentalitetin tonë.

### “Nuk është më e mundur ta konsiderosh enorinë si një vend ku njerëzit vijnë vetë”

Sot çdo prift mendon se detyra e tij kryesore mbështetet në kremtimin e liturgjisë dhe në predikimin. Përgjithësisht priremi të mendojmë se njerëzit do të vijnë vetë në kishat tona dhe do t’i mbushin ato. Për momentin, kjo ndodh shpesh këtu, sepse numri i kishave është ende i pamjaftueshëm në Rusi, veçanërisht në qytetet e mëdha. Megjithatë për të bërë një punë të vërtetë baritore në thellësi duhet të njohim anëtarët e enorisë. Për shembull, a është e mundur të njohim besimtarët që vijnë në bazilikën e Krishtit-Shpëtimtar në Moskë?... Prifti duhet t’i njohë personalisht besimtarët dhe për këtë duhet të rritet numri i kishave. Por që populli të vijë në këto kisha të reja, duhet të ketë përpjekje të vërteta nga ana jonë. Nuk është më e mundur ta konsiderosh enorinë si një vend ku njerëzit vijnë vetë që në çastin kur bien kambanat. Duhet t’i bëjmë vetes këtë pyetje: numri i atyre që vjen vetë në kishë a është i mjaftueshëm në Rusi?

Sipas statistikave, 80% e rusëve janë pagëzuar në Kishën Orthodhokse, por vetëm 60% pohojnë se janë orthodhoksë. Ku janë 20%? Janë pagëzuar, por nuk vijnë në kishë dhe nuk e deklarojnë veten orthodhoksë! Midis 60% orthodhoksëve, mesatarisht me vështirësi 10% shkojnë rregullisht në kishë. Ku janë pra 70% që kanë marrë pagëzimin e shenjtë? Sigurisht që në disa raste shumë njerëz vijnë në kisha,

për shembull, për festat e mëdha, për të pagëzuar fëmijët, për t’u martuar. Kur ka ngjarje të veçanta, numri i njerëzve në kishë rritet. Por këta nuk janë praktikues të rregullt. Gjithashtu duhet të reflektojmë për çështjen se si duhet vepruar me 80% ose të paktën me 50% të bashkëqytetarëve tanë të pagëzuar që të vijnë në kishë? [...]

Të bëjmë kujdes që të mos gënjehemi me iluzionet, sikur çdo gjë të shkonte mirë. Sot patriarku gjendet në Tula, dhe katedralja ishte plot gjatë liturgjisë. Një imazh i tillë të jep përshtypjen se gjithçka shkon për më të mirën. Por është një iluzion i rrezikshëm: qyteti i Tulës numëron 500 000 banorë, dhe nëse 60% e tyre pohon se është orthodhoks, atëherë një numër i barabartë njerëzish do të merrnin pjesë në lutjen tonë të përbashkët. Asnjë kishë e qytetit nuk do të mjaftonte të nxinte këtë turmë, do duhej të celebronim në stadium. Prandaj dhe gjënë e parë që duhet të kuptojmë sot, ju edhe unë, është se situata nuk është aq e përkryer sa duket...

### “Shoqëria pret shumë nga ne”

Ka diçka më të rëndësishme. Nuk e di nëse e keni vënë re atë që thonë mediat. Dëgjojmë shpesh se Kisha Orthodhokse Ruse e ka përforcuar pozicionin e saj në shoqëri, se ajo ka hapur shumë enori dhe manastire, dhe se po bëhet e ndikueshme... Dhe më pas, menjëherë pas këtij afirmimi, bëhen pyetjet e mëposhtme: përse numri i divorceve nuk ulet në Rusi? Përse numri i aborteve nuk pakësohet? Përse përqindja e kriminalitetit nuk reduktohet? Përse ka kaq shumë probleme në shoqërinë tonë për sa i përket respektimit të normave morale etj.?

Statistikat që më kanë bërë të ditur situatën e dioqezës së Tulës janë të mrekullueshme. Por do të ishte më mirë nëse në të ardhmen do të mund të shpallja se për shembull, në qytetin e Tulës, numri i divorceve është pakësuar me x%, numri i aborteve me x%, përqindja e kriminalitetit në x%, korrupsioni po tërhiqet, qëndrimi përballë mjedisit natyral është përmirësuar, problemet ekologjike shkojnë drejt rregullimit...

Ja kriteret në bazë të të cilave duhet të vlerësojmë veprimtarinë e Kishës në shoqëri! Nëse nuk përpiqemi të bëjmë diçka që t’u përgjigjet këtyre kriterëve, atëherë shoqëria do ta humbasë besimin te Kisha. Veprimtaria e Kishës, sot nuk duhet të jetë e vlerësuar vetëm nga numri i kishave dhe i manastireve, por gjithashtu edhe nga shkalla e ndikimit që Kisha ka në jetën e njerëzve, të shoqërisë në tërësinë e saj, përfshirë këtu edhe fushat e tilla si luftën kundër kimit, mbështetjen e familjes, mbrojtjen e jetës.

Kisha u dobësua gjatë viteve të persekutimit, nuk kishte shumë kisha, as edhe seminare.

(vijon në faqen 8)

## “Ne duhet të shkojmë të takojmë popullin tonë”

(vijon nga faqja 7)

Sot, ende nuk i kemi zgjidhur probleme të tilla, gjithmonë na mungojnë priftërinj, kisha... Megjithatë, që atëherë dhe tashmë, shoqëria pret nga ne më shumë. Sigurisht, të gjithë shpresojmë në ndihmën e Perëndisë, dhe Zoti do të na ndihmojë, sepse jemi shumë të dobët. Duhet të ngrihet niveli teologjik i klerit, që çdo prift të zotërojë njohuritë e tij teologjike me punën e tij të vërtetë baritore, në terren, që çdo prift të kuptojë se

teologjia nuk është njohuri teorike, por diçka që është e domosdoshme për të, pa të cilën ai nuk mund të jetojë, sepse në të kundërt nuk mund të japë përgjigje të sakta për pyetjet e njerëzve që shkojnë tek ai. Kemi shumë gjëra për të bërë dhe rruga për të përshkuar është e gjatë.

Në fillim të viteve '90, gjatë diskutimeve me përfaqësues të huaj të besimeve të tjera të krishtera, kam pasur rastin të dëgjoj këto fjalë: “Tani ju jeni të lirë, por nuk keni as seminare,

as shkolla teologjike, as klerikë, as kisha, si do t’ia dilni mbanë të përmbushni të gjitha këto që ju doni të bëni?”. [...] Përgjigjja ime ishte kjo: “Nga pikëpamja njerëzore nuk mund t’i përballojmë të gjitha këto punë, por a do të kishe mundur Kisha gjatë dy mijëvjeçarëve të bënte diçka duke llogaritur vetëm forcat njerëzore? Nëse do ishte kështu, nuk do kishte mbetur sot asgjë nga Kisha. Zoti gjithnjë na ka ndihmuar, edhe sot ne shpresojmë tek Ai.”

(Vijon në numrin e ardhshëm)

### 24 qershor 1992 - Fortlumturia e Tij Anastasi zgjidhet Kryepiskop i Shqipërisë

## Çast vendimtar për ringjalljen e besimit Orthodhoks në Shqipëri

Iniciativën për riorganizimin e Kishës së Shqipërisë e mori Patriarkana Ekumenike me një sërë veprimesh vendimtare. Në janar 1991, Patriku Ekumenik Dhimitri dhe Sinodi i Shenjtë i Patriarkanës caktuan profesorin e Universitetit të Athinës, episkopin e Andrusës (Drejtor i Përgjithshëm i “Shërbimit Apostolik” të Kishës së Greqisë dhe vëzhgues i Mitropolisë së Shenjtë të Irinopolit), Anastasin, eksark patriarkal (të dërguar të Patriarkanës), me mision që të shkonte në Shqipëri për t’u takuar me orthodhoksët dhe autoritetet e vendit.

Pas kundërshtimeve shumë mujore të shtetit shqiptar, Eksarku (i dërguari) i Patriarkanës arriti në Tiranë, më 17 korrik 1991. Gjatë udhëtimit të tij në vend konstatoi shkretimin e tmerr-

shëm që kishte shkaktuar përndjekja e pamëshirshme. Ishin shkatërruar 1608 kisha dhe manastire. Veprimi i parë i Eksarkut ishte krijimi i një strukture thelbësore kishtare për përfaqësimin e Kishës lokale. Për riformimin e strukturës kishtare, Eksarku i Patriarkanës mbledhi Asamblenë e Përgjithshme Kleriko-laikë, 1-2 gusht 1991, me pjesëmarrjen e 15 klerikëve dhe 30 laikëve, nga të gjitha dioqezat e Shqipërisë, në të cilën u studiua gjendja pas regjimit komunist dhe perspektiva, në fund u zgjodhën 4 këshilltarë (epitropë) arkihieratikë dhe Këshilli i Përgjithshëm Kishtar Kleriko-laik me 13 pjesëtarë.

**Përfaqësia e Kishës së Shqipërisë vizitoi Patriarkanën Ekumenike (5-8 qershor**

**1992), për herë të parë pas persekutimit dhe kërkoi zgjedhjen e Eksarkut të Patriarkanës si primat të Kishës së Shqipërisë.**

Sinodi i Patriarkanës Ekumenike, me iniciativën e Patrikut Ekumenik Vartholomeut, për rikrijimin e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, zgjodhi më 24 qershor 1992, me vota unanime, Kryepiskop të Tiranës dhe gjithë Shqipërisë mitropolitin e Andrusës, Anastasin...

Kryepiskopi i ri, pasi dërgoi Mesazhin e Madh në Fanar (Patriarkanë), më 12 korrik 1992, u fronëzua në Kishën Katedrale të Tiranës më 2 gusht 1992, në prani të të gjithë përfaqësuesve klerikë e laikë të krahinave të Shqipërisë.

## 10 vjet më parë



Gjatë vitit 1999, kur vendi ynë priti valët e refugjatëve kosovarë, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, në bashkëpunim me donatorë dhe organizma fetarë ndërkombëtarë (sidomos me

programin ACT, të Këshillit Botëror të Kishave), organizoi një program të gjerë ndihme, prej më shumë se 12 milionë dollarësh, duke pritur në 2 kampe të ngritur prej saj 33 mijë kosovarë.



*Kisha e Shën Nikollës (shek. XVII) në Saraqinishtë, Mitropolia e Gjirokastrës. Ajo është afreskuar në vitin 1630 nga Mihali nga Linotopi.*



## Atë Vasil Nishku i Grabovës

Shekujt e mesjetës e më pas, për Grabovën dhe grabovarët kanë qenë shekuj të një lulëzimi shpirtëror orthodhoks dhe të një lufte të pandërprerë prej pushtuesve osmanë, për t'i detyruar të mohojnë fenë e të parëve e për t'i kthyer në fenë islame. Shumë fshatra për fat të keq e pranuan konvertimin, po Grabova e Sipërme mundi t'ia dalë mbanë. Pas shumë luftërash e përpjekjesh, ruajti besimin dhe kishat e saj, emrin e mirë të trashëguar ndër vite. Nga Grabova qytet, lindën vëllezërit piktorë Çetiri, që pikturuan kishat e zonës së tyre, Pogradecit, Korçës, Beratit, Myzeqesë e më gjërë.

Në Grabovë, çereku i parë i shekullit të njëzetë, gjeti shërbëtor të enorisë së krishterë atë Kozma Ziun. Ai ishte i moshuar dhe nuk mundte më që t'u shërbente besimtarëve dhe kishës së saj. Prifti i Grabovës, përveç fshatit të tij shërbente edhe në kishat e Llëngës së Pogradecit. Një djalë i ri, energjik, besimtar e shumë shpresëtar po rritej në Grabovë. Ishte Vasil Mihal Nishku. Lindi në vitin 1894 dhe u rrit në gjirin e familjes e të kishës.

Pasi mbaroi shkollën në gjuhët greqisht e rumanisht në Pogradec, Vasili i ri mësoi shqipen fshehurazi

në shpellën e gurit, në jug të fshatit. Abetaren e sillnin po fshehurazi mërgimtarët.

Në vitin 1929, pasi ishte përgatitur mendërisht e shpirtërisht, hironiset në Berat e menjëherë vjen të shërbejë në Grabovë. Atë Kozma Ziu, të cilin e zëvendësoi, i dha uratat dhe bekimet, dhe atë Vasili nisi shërbesën me përkushtim, dashuri e zell të madh në kishë dhe tek besimtarët e saj. Shpesh, atë Vasili shoqëronte bashkëfshatarët me tufat e bagëtive për dimërim në Myzeqe, Delvinë e deri në Sarandë. Atje takoi e njohu plot bashkëmeshtarë që u bënë për tërë jetën miq e shokë. Ata ia kthenin vizitën në muajt e verës dhe kisha e Grabovës mori më shumë bekim e shenjtërim. Po kështu, për verim në Grabovë vinin nga Elbasani edhe priftërinjtë atë Naun Peçini e atë Naun Korçari.

Atë Vasili dhe priftëresha rritën pesë vajza dhe tre djem. Meshonte në dy kisha, në të Shën Kollit dhe të Shën Parashqevisë, pa lënë mënjanë edhe dy parakliset e plot vende kishash në fshatrat e tjerë, tanimë me popullsi myslimane, ku bënte lutje e ajazmë. Kështu rrodhën vitet e jetës së atë Vasilit në Grabovë, me lutje, punë e përkushtim. Zëri i tij melodioz, bënte që orët e litur-

gjisë të shkonin pa u ndjerë.

“Atë Vasili, - tregojnë bashkëfshatarët e tij, - ishte një klerik i denjë për enorinë. Ai ishte i sjellshëm, mikpritës, bujar dhe rrezatonte një dashuri të pakufishme për të gjithë. Në shërbesat që kryente te besimtarët, në asnjë rast nuk kërkonte e merrte shpërbllim prej tyre dhe gjithnjë thoshte më del e tepron ajo që më jep kisha.” Si fshat i vetëm orthodhoks dhe si i vetmi prift i rrethit të Gramshit, gëzonte respekt tek të gjithë. E donin edhe banorët myslimanë dhe e nderonin të gjithë. Fëmijët e atë Vasilit u shkolluan në profesione të ndryshme e punuan si inxhinier, arsimtar etj.

Mbyllja e kishave e rëndoi shumë në shpirt. Iu dhimbs pa masë mbyllja e kishës në Grabovë dhe lënia e besimtarëve pa bari. Erdhi të banojë te djali në Gramsh, po shpirti i rrinte gjithnjë në Grabovë. Si në Gramsh edhe në fshat shkonte për të bërë pagëzime e kurore zime fshehurazi. Besimtarët e deshën, ndaj asnjëherë nuk doli fjala për punën që bënte.

Kur u sëmur e pa se po afronte dita të flinte e të shkonte pranë Perëndisë, iu lut fëmijëve ta dërgonin në Grabovë, të kalonte ditët e fundit e të çmallej me fshatin e të

varrosej atje. Duke ndenjtur pranë dritares, shikonte kambanoren që heshtte e kishën që flinte nën kuroret e pemëve e i vinte për të qarë. Kështu i kaloi ditët e fundit të jetës tokësore, me besë e me shpresë. Me shpresë, se sërish do hapeshin dyert e kishave dhe të gjëmonin përsëri kambanat.

Atë Vasili, prifti i mirë i Grabovës, fjeti më 24 gusht 1973.

*Atë Stavri Çipi*



**NGJALLJA**

Organ i Kishës Orthodhokse  
Autoqefale të Shqipërisë

**Themelues:**  
**Kryepiskopi Anastas**

**Del nën kujdesin**  
**e Këshillit Botues**

**Kryeredaktor: Thoma Dhima**

**Adresa:**

**Kryepiskopata Orthodhokse,**  
**Rruga e Kavajës, Nr. 151**  
**Tiranë**

**Tel: (04) 2234 117, 2235 095.**

**Fax: 2232 109**

**Shtypur**  
**në shtypshkronjën “Ngjallja”**

## Mendime mbi lutjen

(vijon nga numri i kaluar)

**Që Krishti të vijë tek ne,  
duhet që zemra të jetë e pastër**

Hiri hyjnor na mëson detyrën tonë. Ky hir nuk vjen veçse po ta tërheqim me dashurinë tonë dhe dëshirën për të. Hiri i Zotit sjell edhe dashuri hyjnore dhe kjo na mjafton për t'u lutur. Krishti do të vijë e do të qëndrojë në shpirt mjafton të gjejmë disa gjëra të vogla që atij i pëlqejnë si vullneti i mirë, përlësia e dashuria. Pa këto nuk mund të themi: "Zot, Jisu Krisht, mëshiro më." Në këto kushte shpirti komunikon me Perëndinë, i dëgjon zërin, merr fjalën e Tij, merr fuqi, hir hyjnor dhe transformohet. Shpirti kthehet drejt Perëndisë me butësi dhe arrin në pendim. Që Krishti të vijë tek ne kur e thërrasim nëpërmjet lutjes, duhet që zemra të jetë e pastër, të mos ketë asnjë pengesë, të jetë e çliruar nga çdo urrejtje, egoizëm, ligësi. Duhet ta duam e të na dojë. Nëse ndërjegjja na dënon në ndonjë gjë, ka një sekret për të dalë nga kjo. Ky sekret është të kërkojmë të falur ose të flasim me atin shpirtëror. Por kjo kërkon përlësi. Nëse je i qetë, ke ndërjegje të pastër e kryen vepra të mira, ti hyn kështu në lutje qetësisht, pa e kuptuar. Më pas pret thjesht, me durim, që hiri të vijë. Çdo gjë që të ndodhë, qortoni veten tuaj. E rëndësishme është të luteni me frymë të përlur e jo të justifikoni veten. Dëgjoni shpifje për veten? Lutuni! Lutuni, pasi "shushuritjet e murmuritjet nuk i shpëtojnë" (Fjalët e Urta 1.10). Murmuritja më e vogël kundër të afërmit ndikon në shpirt e kështu nuk mund të luteni. Kur Shpirti i Shenjtë e gjen shpirtin në një dispozitë të tillë nuk mund t'i afrohet.

**T'i kërkojmë Zotit që vullneti  
i Tij të përmbushet në jetët tona**

Lutjet tona nuk plotësohen, sepse nuk jemi të denjë. Duhet të jesh i



denjë që të mund të lutesh. Nuk jemi të denjë, sepse nuk e duam të afërmin si veten. Fillimisht, shko pajtohu me vëllain, që të të falë, dhe atëherë do të bëhesh i denjë. Nëse nuk je i denjë, nuk mund të bësh asgjë. Kur të kesh rregulluar gjithçka dhe do të jesh gati, shko dhe paraqit blatën tënde. Bëhen të denjë ata që dëshirojnë dhe luftojnë t'i përkasin Krishtit, ata që jepen tërësisht pas vullnetit të Perëndisë. Të mos kesh asnjë vullnet, kjo ka një vlerë të madhe, gjithçka qëndron në këtë. Kjo realizohet me dashuri për Krishtin dhe duke zbatuar porosinë e Tij. Lufta është e nevojshme. Na duhet të luftojmë kundër fuqive të errësirës. Kjo kërkon lot, pendim, lutje, lëmoshë, besim te Krishti dhe jo pak besim. Vetëm Krishti mund të na nxjerrë nga humnera e braktisjes. Jepni një gotë ujë kur nuk keni para. Sa më shumë të shenjtëroheni, aq më shumë do t'u dëgjohen lutjet. Të mos i kërkojmë Zotit të na çlirojë nga diçka, nga sëmundjet ose të na zgjidhë këtë apo atë problem, por le t'i kërkojmë mbështetje e fuqi që t'i përballojmë.

Perëndia ka gjithashtu sekretet e Tij. Përderisa besojmë në përkujdesjen e Tij të mirë, përderisa besojmë se Ai nesh gjithçka në jetën tonë, e që do të mirën për ne, përse të mos I kemi besim? Le të lutemi butësisht, gjithmonë, pa pasion e pa e sforcuar veten. Ashtu siç thotë edhe apostull Pavli: "Nuk ka asnjë krijesë që të jetë e fshehur para Perëndisë, por të gjitha janë të zhveshura dhe të zbuluara në sytë e atij, të cilit do t'i japim llogari" (Heb.4.13).

Sa për ne, të mos insistojmë, pasi kjo mund të na bëjë më shumë keq se mirë. Të mos vrapojmë për të marrë atë që ne duam, por le ta besojmë të gjithë këtë në duart e Perëndisë. Sa më shumë e lakmojmë diçka, më shumë na largohet. Si rrjedhim na duhet durim, besim dhe kthjelltësi. Edhe nëse e harrojmë ne kërkesën tonë, Zoti nuk e harron asnjëherë. Nëse është për të mirën tonë, Ai do na i japë në momentin e duhur. Në lutje le të kërkojmë vetëm shpëtimin e shpirtit. A nuk tha Zoti: "Kërkoni së pari mbretërinë e Zotit... e gjithçka do t'ju jepet"?

**Duhet të shkojmë vetë tek Perëndia me thjeshtësi dhe pastërti zemre**

Kur kemi me Krishtin një lidhje besimi absolut, jemi të lumtur e të gëzuar. Kemi gëzimin e parajsës. Dhe së bashku me apostull Pavlin thërresim: "Për mua të jetuarit është Krishti, dhe vdekja është fitim" (Fil.1,21) "Dhe nëse jetoj, nuk jam më unë, por Krishti që jeton tek unë" (Gal.2,20). Le të shkojmë vetëm te Krishti me thjeshtësi dhe pastërti zemre. Çfarë thotë Solomoni i urtë? Thjeshtësia është e nevojshme. Thjeshtësia është përlësi e shenjtë, d.m.th. besim absolut në Krishtin. Le të japim jetën tonë te Krishti. Në jetën shpirtërore luftoni me thjeshtësi, me butësi dhe pa dhunim. Thjeshtësia e butësia janë dy mënyra të shenjta të jetës shpirtërore, por nuk është e mundur t'i mësohen nga jashtë. Duhet që këto të hyjnë fshehtëzi tek ty, me qëllim që shpirti t'i adoptojë përmes hirit të Perëndisë. Kur dëshiron diçka dhe përpiqesh ta dhunosh Zotin që të ta japë, këtë gjë nuk e merr. Por do të vijë në ditën kur nuk e pret dhe në orën që nuk e di. Kur e humbni hirin hyjnor, mos bëni asgjë. Vazhdojeni me thjeshtësi be tejën tuaj, pa ankth, derisa dashuria dhe dëshira e zjarrtë për Krishtin të rikthehen sërish. Dhe atëherë gjithçka do të shkojë mirë. Hiri do t'ju mbushë e do t'ju gëzojë. Ndiqni shërbesat liturgjike dhe hiri do të vijë mistikisht.

(vijon)

Nga jeront Porfiri  
Përktheu E. Pani

## Kalendari i

### Liturgjive Hyjnore, KORRIK 2009

**1 E mërkurë** † Anargj. Kozma e Damian, romanë. Osh. Petro patrici. (Hahet vaj e verë.)  
**4 E Shtunë** † Andrea i Kretës. Mihail Honiati i Athinës. Dëshg. Kiprila.

**5 E DIEL † 4 MATEUT.**  
Osh. Athanas athoniti. Osh. Lambadhi.

**6 E Hënë** † Hierod. Asti i Durrësit. Osh. Sisoj. Dëshg. Luçia.  
**8 E Mërkurë** † Dëshm. Prokopi e Theodhosia, nëna e tij. Hierod. i ri Anastasi.

**10 E Premte** † Dësh. i ri Nikodhimi në Berat. 45 dësh. në Armeni.

**11 E Shtunë** † Dëshmg. Efimia. Mbret/sha Ollga. Dësh. i ri Nektari.

**12 E DIEL † 5 MATEUT.**  
Dësh. Prokli e Ilariu. Veronika, gjakrrjedhësja.

**17 E Premte** † Dëshmg. Marina. Dësh. Sperati dhe Veronika. (Hahet vaj e verë.)

**18 E Shtunë** † Dësh. Emilia-ni, Thea, Valentina, Markeli. Osh. Pamvoi.

**19 E DIEL † E ETËRVE  
SIN. IV EK.** Oshg. Makrina. Osh. Dhiosi.

**20 E Hënë** † Pr. Ilija Thesviti. Osh. Avrami në Radonezh.

**22 E Mërkurë** Maria Magdalena, miroprurëse. Dëshg. Markela në Hios. (Hahet vaj e verë.)

**24 E Premte** † Dëshmg. Kristina. Omol. Athinagora. Dësh. Borisi e Gljebi.

**25 E Shtunë** † Fjetja e Sh. Anës. Oshg. Olimpiadha. Sin. V Ekumenik.

**26 E DIEL † 7 MATEUT.**  
Oshg. Parashqevia (Premtja). Hierod. Hermolau etj.

**27 E Hënë** † Dëshm. Pandleimoni. Osh. Gorazdi, Ange-lari, Klementi.

Për më tepër informacion rreth

**KISHËS ORTHODHOKSE AUTOQEFALE TË SHQIPËRISË**

vizitoni faqen tonë të internetit

[www.orthodoxalbania.org](http://www.orthodoxalbania.org)

ose na kontaktoni në [orthchal@orthodoxalbania.org](mailto:orthchal@orthodoxalbania.org)

## HIMNE KISHTARE BIZANTINE 7

## KANONI I PARAKLISIT TË VOGËL I HYJLINDËSES MARI



Kjo CD, është vazhdim i asaj të mëparshme (nr. 6, Shërbesa e Himnit Akathist), që gjithashtu i përkushtohet së Tërëshenjtes sonë. Në Paraklisin e Vogël (si dhe në të Madhin), njeriu mëkatar, i pafuqishëm, i munduar, i sëmurë dhe i varfër shpirtërisht e trupërisht, pra çdonjëri nga ne, i drejtohet nënës së Krishtit dhe kërkon ndërmjetimin e saj.

Hyjlindësja ka fuqi dhe guxim të Zotit, sepse është nëna e Tij e tërëdëlirë dhe e panjollë. Por është edhe nëna jonë zemërdhembshur, pasi Jisui ynë është “i parëlinduri ndër shumë vëllezër” - jemi vëllezërit e Tij dhe nëna e Tij është, do të thoshim, edhe nëna jonë.

Edhe diçka më shumë: E di çfarë do të thotë dhimbje... Shpata që kishte profetizuar Hyjpriti Simeon dhe që e përshkoi zemrën e saj gjatë Kryqëzimit, ishte aq shumë e dhimbshme, sa nuk mund të imagjinohet. Kështu, ajo na kupton edhe ne kur vuajmë dhe bëhet ndërmjetuesja më e fuqishme - njeriu ynë i afërm!

Paraklisi psalet në çdo kohë, por është caktuar të psalet rregullisht gjatë periudhës së 15 Gushtit. Ai jepet i plotë në fletëpalosjen e CD-së.

Kori Bizantin “Shën Joan Kukuzeli” i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë drejtohet nga Arkim. Justini. Regjistrimi u krye në studiot e Shoqërisë Fonografike “Ehogenisi” në Trikala, më 2.10.08 gjatë pelegrinazhit në Meteora. Inxhinieri i zërit ishte protopsalti z. Panajotis Kalambakas.

### Igori, mbret i Kievit (5 qershor)

Ishte i biri i Oljeg Sijatoslaviçit, sundimtar i Çernigovit. Lindi në Kiev rreth vitit 1116. Në vitin 1146 (ose 1147) zuri vendin e vëllait të vet, Vsevolondit, hegjemoni i madh i Kievit. Nënshetasi iu lutën t’i jepte fund padrejtësive dhe detyrimeve të rënda që u kishte vënë vëllai. Pranoi, por nuk veptoi menjëherë, ndaj ata intriguan me sundimtarin e Perejislavit kundër tij. Shenjtori iu drejtua farefisit të tij, sundimtarëve të Çernigovit, të cilët pas negociatash të gjata bënë aleancë me të. Mirëpo humbi në betejë, sepse u braktis nga kalorësit e tij... U kap dhe u burgos në një manastir, ndërsa hegjemoni fitimtar i Perejislavit përvetësoi fronin e Kievit. Për një kohë të shkurtër Igori (d.m.th. Gjergji) kërkoi që të qetëj murg dhe u transferua nga atje ku ishte i burgosur në një qeli. Kishte një javë plot që përpëlitej në shtratin e vdekjes, por u shërua sapo u bë murg nga një episkop! Mori “skema monakale” në Manastirin e Shën Theodorit në Kiev. Armiqtë e Igorit vazhduan të komplotonin kundër tij. Arritën deri aty sa mblodhën turma dhe e sulmuan në manastir. E gjetën në Liturgjinë Hyjnore të lutej para ikonës së të Tërëshenjtes, e cila më vonë përfundoi në Lavra Kievopereskaja, manastir i famshëm. E nxorën zvarrë jashtë duke ulëritur dhe i shqyen rason. E shpëtoi për momentin një hegjemon, Vladimiri, por kryengritësit u sulën në shtëpinë



ku e strehoi dhe e therën e masakruan (19 ose 9.9.1147). Më pas lipsanin e shenjtë të tij e tërhoqën zvarrë nëpër rrugët e qytetit dhe e hodhën në një treg. Njerëzit e Vladimirit e gjetën dhe e morën. Gjatë varrimit shpërtheu një stuhi e tmerrshme, diçka e perëndishme, saqë populli i frikësuar u pendua dhe qau për vrasjen e mbretit të ri në moshë. Lipsani u depozitua në një kishë të Çernigovit. Më pas u bë një luftë civile shkatërrimtare. Sot kremtohet zhvarrosja e tij (1150) dhe jo kujtimi i tij kryesor që nuk festohet kurrë - fenomen i çuditshëm në Agjiologji.

### Theodhoti martir (7 qershor)

U martirizua në vendin e tij Ankara, Azia e Vogël, ka gjasa gjatë perandorisë së Dioklecianit (284-305). Ishte shpresëtar, i martuar. Merrej me tregti drithërash dhe njëkohësisht bukëpjekës. Shpeshherë u shpërndante bukë të varfërve dhe të burgosurve të krishterë, të cilët i inkurajonte në besim. Kur arkondi spërkati ushqimet me verë nga flijime idhujsh, që të “ndoteshin” të gjithë, ai i furnizoi me bukë besimtarët dhe ata nuk u njollosën. Ai e kishte kthyer dyqanin në sallë mbledhjesh. Njëherë gjeti në burg dhe hallën e vet, Tekusën, bashkë me shtatë virgjëresha vendëse, Aleksandinën (ose Aleksandrën), Klaudian, Fainen, Efrasinën, Matronën, Julian dhe Theodhotën (festohen më 18 maj). Meqenëse nuk u bënë flijime idhujve, i dorëzuan tek ushtarët që të çnderoheshin, por i shpëtoi ndihma hyjnore. Ato i hodhën në liqenin që ndodhej aty pranë të lidhura me gurë në qafë dhe i dhanë fund jetës së tyre. Tirani i pamëshirshëm urdhëroi që të mos varroshin lipsanet e shenjta. Por shenjti i mblodhi bashkë me të krishterë të tjerë dhe i va-

rrosi. Shenjtin e tradhtuan dhe e kapën. E rrahën egërsisht, e varën, e çorën, i hodhën në plagë uthull e kripë dhe më në fund i prenë kokën. Lipsanet e nderuara të grave i zhvarrosën dhe i dogjën... Titulli i sinaksarit më 18 maj flet për shtatë vajza, por në tekst shkruhet të teta. Pra u supozua se Tekusa nuk është emër, por mbiemër = lindësja (e shtatë virgjëreshave). Ekziston mundësia për një tjetër Efsaria martire që pason në sinaksar, e cila u mbyt gjithashtu, u fut gabimisht në grupin e shtatë virgjëreshave, saqë u bënë tetë; në një rast të tillë edhe Tekusa ishte e virgjër. Për shën Efrasinën, të dytën, nuk disponojmë të dhëna të tjera. Gjithashtu, më 20 mars nderohen shtatë martire virgjëresha në Amison (Azia e Vogël), Aleksandria, Klaudia, Efrasia, Matrona, Juliana, Efimia dhe Theodhosa (ose Theodhora). Megjithatë emrat ngjajnë shumë, duket se janë persona të tjerë, meqë ndryshon vendi, torturimi dhe mbarimi i tyre. Shën Theodhoti kremtohet përsëri më 18 maj së bashku me bashkatletet, të cilat ai i varrosi.

Atë Justini

## Hap përpara i institucioneve tona arsimore

*Godinë e re për shkollën "Protagonistët" afër qendrës së kryeqytetit.  
Pas mbarimit të klasës së 9-të, do vijojnë edhe vitet e shkollës së mesme.*

Në territorin e kishës "Ungjillëzimi i Hyjli-ndëses", në kryeqytet, në Rugën qendrore të Kavajës, bie në sy tashmë një godinë e bukur dhe me një arkitekturë sa të veçantë dhe bashkëkohore.

Ajo u ngrit me fondet e siguruar dhe sidomos me kujdesin e drejtpërdrejtë të Kryepiskopit Anastas, i cili ishte edhe ideatori i destinacionit të saj: Shkollë 9-vjeçare dhe më pas e mesme, pas mbarimit të klasës së 9-të nga nxënësit e shkollës Shqiptaro-amerikane "Protagonistët". Kjo shkollë, kaq e suksesshme që nga viti 2002, kur hapi dyert për herë të parë, sot do të jetë edhe më konkurruese mes shkollave të tjera jopublike jo vetëm me cilësinë e mësimdhënies, por edhe të mjediseve të saj.

Godina është 7-katëshe, e konceptuar për nevojat e procesit mësimor, me ajrim dhe ndriçim të bollshëm natyral. Sipërfaqja e çdo kati është 330 m<sup>2</sup> dhe lartësia e çdo kati është 3.2m. Objekti ka struktura të posaçme edhe për persona me aftësi të kufizuara, duke plotësuar kështu të gjitha standardet shqiptare dhe evropiane.

Gjithçka në këtë godinë është bashkëkohore, sistemi i ndërtimit, i sigurisë, i ngrohjes qendrore,



i mjediseve ndihmëse, kuzhina, klasat, kabINETET mësimore, terreni sportiv (që do të ndërtohet gjatë pushimeve të verës) etj. Madje, ka dhe një amfiteatër të bukur, ku mund të realizohen shfaqjet e nxënësve, mbledhje e veprimtari të ndryshme mësimore e argëtuese.

Shkolla në vitin mësimor 2009-2010, do të arrijë në klasën e 8-të dhe vitin e ardhshëm do të plotësojë ciklin 9-vjeçar, i cili do të pasohet edhe me shkollën e mesme, duke plotësuar ciklin e plotë të studimeve prej 12 vjetësh.

Në godinën e re do mësojnë nxënësit e klasave 4-9. Tri klasat e para do të vazhdojnë të funksionojnë në mjediset moderne, mes gjelbërimit të Parkut të Madh, pranë kishës së Shën Prokopit.



"Protagonistët" është themeluar nga fondacioni "Frymë Dashurie", një organizatë për zhvillim dhe edukim, e themeluar me iniciativën e Fortlumturisë së Tij Anastasit, Kryepiskop i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë. Shkolla është hapur në shtator 2002, për të ofruar një mundësi të re dhe bashkëkohore arsimit dhe edukimit në Shqipëri. Shkolla është aprovuar dhe licensuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

### Filozofia jonë

Ne besojmë që shkolla është një bashkësi ndërmjet nxënësve, mësuesve dhe familjes, të cilët punojnë së bashku për të kultivuar një jetëgjatësi të të mësuarit. Ne besojmë që çdo nxënës ka dinjitet dhe meriton respekt. Fëmijët janë individë që kanë mendimet, ndjenjat dhe interesat e tyre. Aftësitë dhe ajo çka ofron secili duhet të ushqehen dhe të rriten në një mjedis pozitiv dhe me përkujdesje.

Ne besojmë që fëmijët kanë një dëshirë të lindur për të mësuar dhe kjo përvojë edukative dhe sfiduese do të nxisë natyrshëm interesin e tyre. Ne besojmë se shkollimi do t'i përgatisë nxënësit për të ardhmen, duke pasur parasysh kërkesat e tyre në tërësi, si ato fizike, intelektuale, emocionale, ashtu edhe ato shoqërore e shpirtërore. Tek nxënësit do të kultivohen aftësi dhe dije që do t'i përgatisin ata që të kenë një jetë të suksesshme, si në planin profesional edhe në atë personal.

### Misioni ynë

Si një bashkësi shkollore ne do t'i edukojmë nxënësit me një atmosferë të ngrohtë dhe respekti të ndërsjellë, duke i inkurajuar të shkëmbejnë idetë e të nxisim vetëbesimin. Ne do t'u ofrojmë materiale edukative nëpërmjet aktiviteteve krijuese dhe të këndshme që vënë në përdorim logjikën dhe përfshijnë në punë nxënësit, me qëllim që

ata të mësojnë në mënyrë aktive. Me ndihmë dhe vëmendje të veçantë për çdo nxënës, do të synojmë të ngremë sa më lart aftësitë e tyre. Do t'u japim nxënësve mjetet e duhura për t'i përgatitur për një arsimim të mëtejshëm dhe për t'i përballur me sfidat e së ardhmes, duke aftësuar në zgjidhjen e problemeve, mendimin kritik, në përdorimin e kompjuterit dhe gjuhës angleze.

Do t'u rrënjosim një ndjenjë të lartë përgjegjësie dhe udhëheqjeje, konceptet për të qenë pjesëtarë të denjë të botës së qytetëruar, si të gjejnë zgjidhje për konfliktet, si të ndërtojnë marrëdhënie shoqërore, si të kujdesen për mjedisin, gjithashtu si të jenë të dhembshur e të respektojnë veten dhe të tjerët. Do t'u krijojmë një mjedis që i lejon nxënësit të kenë rezultate që tani dhe t'i përgatisë ata për një jetë të suksesshme.

- Ne ofrojmë klasa të vogla, vëmendje të veçantë për çdo nxënës me mësues dhe asistentë në shkolla fillore.

- Metoda mësimdhënëse krijuese, që kanë në qendër të vëmendjes psikologjinë fëmijërore, duke zbatuar metodat bashkëkohore amerikane.

- Muzikë, art dhe edukim fizik me specialistë të lëndëve përkatëse.

- Çdo ditë mësim të gjuhës angleze nën mbikëqyrjen e mësuesve amerikanë.

- Kompjuterë për përdorim dhe përgatitje.

- Një bibliotekë të pasur me libra shqip dhe anglisht për fëmijë.

### Pranimi

*Të gjithë nxënësit janë të mirëpritur të aplikojnë. Pranimi bazohet në përgatitjen dhe potencialin që çdo nxënës do të ofrojë në pasurimin e komunitetit të shkollës "Protagonistët". Nxënësit duhet të aplikojnë në maj për vitin e ri shkollor. Kontaktoni me shkollën për më tepër informacion mbi aplikimin dhe pagesën.*